

Në bazë të nenit 173, të Ligjit për arsimin e lartë (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër: 82/2018*), nenit 158 të Statutit të Universitetit të Tetovës, në lidhje me Konkursin për zgjedhjen e mësimitdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe për zgjedhje në thirrje të bashkëpunorëve në Universitetin e Tetovës, të shpallur më: 22.10.2020, në web faqen e Universitetit të Tetovës, si dhe gazetat ditore: “Koha” dhe “Nova Makedonija”, këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, në mbledhjen e mbajtur më datë: 13.11.2020, solli vendim për formimin e komisionit recenzues në këtë përbërje:

- 1. Prof. Dr. Xhabir Abdullahu – kryetar;**
- 2. Doc. Dr. Ismail Ferati – anëtar;**
- 3. Doc. Dr. Gafur Xhabiri – anëtar.**

Në konkursin e shpallur për zgjedhjen e një asistenti për lëndët mësimore në fushën e teknologjisë ushqimore, ka aplikuar kandidati:

- 1. Mr. Sc. Durim ALIJA**
- 2. Mr.sc Valbona MAZLLAMI**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit komisioni konstatoj që kandidatja Valbona Mazllami ka aplikuar pas afatit të përcaktuar në konkurs (kandidatja i ka dorëzuar me postë dokumentacionin më datë 30.10.2020, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit ka qenë 29.10.2020), prandaj komisioni nuk e ka shqyrtuar dosjen e kandidatës Valbona Mazllami.

Duke iu referuar asaj që konstatuam më lartë, komisioni recensues ka nderin që këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit t'ia paraqesë këtë:

RAPORT RECENSUES

1. Mr.Sc. Durim ALIJA

1.1 Të dhënat biografike

Durim Alija ka lindur më 17 Gusht 1994 në Tetovë.

Shkollimin fillor e ka kryer në shkollën 'Kirili dhe Metodij' në Tetovë në vitin 2009.

Në vitin 2013 ka mbaruar shkollimin e mesëm në Gjimnazin e Tetovës 'Kiril Pejçinoviç'.

Në vitin 2013 ka regjistruar studimet e ciklit të parë në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, drejtimi: Teknologji Ushqimore, në Universitetin e Tetovës.

Studimet i i ka kryer në gjuhën Shqipe.

Në vitin 2016, pas përfundimit të studimeve në afat të rregullt, mori titullin: 'Inxhinier i teknologjisë ushqimore'.

Pas përfundimit të studimeve deri-diplomike, në vitin 2016 ka regjistruar studimet post-diplomike (studimet e ciklit të II-të), në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit - Universiteti i Tetovës.

Në vitin 2019, ka mbaruar studimet, duke mbrojtur me sukses dhjetë (10), tezën me titull: **"Vlerësimi krahasues i përmirësueseve (aditivëve) në cilësitë sensorike, reologjike dhe brumbërëse të miellit nga kultivarë të ndryshëm të grurit"**, kështu dhe fitoi titullin: 'Magjistër i teknologjisë ushqimore'.

1.2 Përvoja e punës

Pas përfundimit të studimeve deri-diplomike në vitin 2016, menjëherë u angazhua si laborant në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit. Gjatë kësaj periudhe kandidati mori njohuri praktike të theksuara si dhe kreu obligimet dhe detyrimet të listuara si më poshtë:

1. Veprimtari menaxhuese në laboratorë;
2. Zgjedhja e problemeve statistikore në veprimtarinë e punës së laborantit;
3. Përgatitja e mostrave dhe produkteve ushqimore për të kryer analizat përkatëse;
4. Përgatitja e vendeve, pajisjeve dhe materialeve të punës për kryerjen e analizave laboratorike;
5. Parashikimi dhe mënjanimi i shkaqeve dhe rreziqeve të mundshme në laborator;
6. Zbatimi i rregullave dhe normave për ruajtjen e mjedisit të laboratorit;
7. Përpilimi, dokumentimi dhe arkivimi i dokumentacionin laboratorik;
8. Përkthimi i aparaturave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe;
9. Pjesëmarrja gjatë ushtrimeve;
10. Pranimi i delegacioneve të ndryshme;

11. Përkrahja e studentëve të ciklit të parë dhe të dytë gjatë hartimit të tezave të diplomës, gjegjësisht të masterit;
12. Kujdesi për mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike.

Gjatë vitit akademik 2018/19 u bë pjesë përbërëse e kuadrit dhe personelit për procesin e akreditimit të “Labororit për kontrollin e produkteve ushqimore”, sipas standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe EN/ISO 19011:2011.

1.3 Veprimtaria edukativo - arsimore

Nga viti akademik 2017/2018, u angazhua si asistent me kontratë në vepër në programet studimore: Teknologji ushqimore; Të ushqyerit dhe Menaxhimi me cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit - Universiteti i Tetovës.

Gjatë kësaj periudhe asistoi në mbajtjen e pjesës praktike, gjegjësisht ushtrimeve në lëndët:

- Teknologjia e përpunimit të drithërave
- Teknologjia e përpunimit të fruta-perimeve
- Kontrolli i kualitetit të produkteve ushqimore
- Cilësia dhe siguria e ushqimit
- Bazat e toksikologjisë
- Kimia ushqimore
- Kimia dhe biokimia ushqimore
- Bioteknologji ushqimore
- Operacionet teknologjike 2
- Lënda e parë në industrinë ushqimore 1
- Lënda e parë në industrinë ushqimore 2

Gjatë kësaj periudhe, Mr.Sc. Durim Alija ka marrë pjesë edhe nëpër projektet “*ERASMUS PLUS*” edhe atë në “*ERASMUS +, Youthpass, Participant in a learning mobility project: Youth Entrepreneurship in Rural Areas, 05-11,07,2018, Smolyan-Bulgaria*” dhe “*ERASMUS +, Youthpass, Participant in a learning mobility project: “GET ACTIVE LOCALY”, 27,08- 02,09,2018, Minsk-Belarus*”

1.4 Veprimtaria shkencore- hulumtuese

Mr.Sc. Durim Alija veprimtarinë shkencore-hulumtuese e filloi me pjesëmarrjen në Konferencën e gjashtë studentore të mbajtur në Tiranë, 14 qershor 2017. Konferenca kishte karakter garues-shkencor, me çka e fitoi vendin e parë. Titulli i punimi me të cilin garoi kandidati ishte “Sa njihen ushqimet e modifikuara gjenetike nga popullata e zonës së Pollogut” (<https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/konferenca-studentore/historiku/konferenca-vj>).

Në vitin 2017, kandidati publikoi edhe punimin e rradhës në shtëpinë botuese internacionale “LAP LAMBERT ACADEMIC PUBLISHING” – Germany, me titull “**Control of Vitamin C (Ascorbic Acid) in Non-Alcoholic and Fresh Drinks**” me ISBN 978-620-2-19756-4 (<https://www.morebooks.de/store/gb/book/control-of-vitamin-c-ascorbic-acid-in-non-alcoholic-and-fresh-drinks/isbn/978-620-2-19756-4>). Vlen të theksohet se po në këtë shtëpi botuese kandidati botoi edhe një punim tjetër shkencorë me titull “**Study of quality and safety parameters in raw raspberries**” me ISBN 978-620-2-81663-2 (<https://morebooks.de/store/gb/book/study-of-quality-and-safety-parameters-in-raw-raspberries/isbn/978-620-2-81663-2>)

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit është e pasur me punime shkencore të ndryshme, të përmbledhura në pika të shkurtëra në pjesën në vijim. Gjithashtu vlen të përmendet se kandidati bën rishikime të punimeve shkencore në “JOURNAL OF PHARMACY AND PHARMACOLOGY”.

1. Xhezair Idrizi, Renata Kongoli, **Durim Alija**(2020): Study and Safety Parametrs in Raw Raspberries, LAP LAMBERT Academic Publishing, ISBN:978-620-2-81663-2;
2. **Durim ALIJA**, Kaltrina SEJDIU, Anila POLLOZHANI, Fatbardha TËRSTENA, Gentrir RRUSHITI.(2019) Comparison of pommetric and physico-chemical parameters of mutsu and red delishes apples. INTERNATIONAL CONGRESS ON NATURAL, HEALTH SCIENCES AND TECHNOLOGY;
3. Ismail FERATI, Namik DURMISHI, **Durim ALIJA**, Arta SALLAI. (2019) Microbiological characteristics of technological water in the food industry. INTERNATIONAL CONGRESS ON NATURAL, HEALTH SCIENCES AND TECHNOLOGY;
4. Xhezair IDRIZI , Xhabir ABDULLAHI , **Durim ALIJA**, Gafur XHABIRI, Namik DURMISHI, Ismail FERATI.(2019) The protein content in some beans populations in Northwestern Macedonia. INTERNATIONAL CONGRESS ON NATURAL, HEALTH SCIENCES AND TECHNOLOGY;
5. Xhezair IDRIZI, Merije ELEZI, Hava MIFTARI, Erhan SULEJMANI, Fejzullah FEJZULLA, **Durim ALIJA**.(2019) Possible application of herbs as functional products in food industry. INTERNATIONAL CONGRESS ON NATURAL, HEALTH SCIENCES AND TECHNOLOGY;
6. Ismail Ferati, Namik Durmishi, Xhezair Idrizi, Gafur Xhabiri, Hava Miftari, **Durim Alija** (2019), Effect environmental factors on microbiological quality of flour, ISBN 978-9951-550-19-2, <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2019/events/432/>
7. Besim Ismaili, **Durim Alija**, Xhezair Idrizi (2018) Nutritionism for Athlets. 5th International Balkan conference in Sport science;
8. Xhezair Idrizi, Xhabir Abdullahi, Gafur Xhabiri, **Durim Alija** (2018), The evulation of phenotypic variation of native populations of bean in Macedonia, International Journal of Food Technology and Nutrition, Volume1, Issue1-2, Pages19-23 Publisher.Faculty of Food Technology and Nutrition, Tetova, Republic of North Macedonia. <https://scholar.google.com/scholar?cluster=1092522638864063889&hl=en&oi=scholarr>.
9. Idrizi, Xhezair and Abdulla, Xhabir and Xhabiri, Gafur and **Alija, Durim** (2018). *The Evulation of phenotypic variation of native populations of beans in Macedonia.*

- International Journal of Food Technology and Nutrition*, 1 (1-2). pp. 19-23. ISSN 2671-3071;
10. **Durim Alija**, Eljesa Ziberi, Xhezair Idrizi. Control of Vitamin C (Ascorbic Acid) in Non-Alcoholic and Fresh Drinks Paperback – (2017). Paperback : 64 pages, ISBN-10 : 6202197560, ISBN-13 : 978-6202197564, Publisher : LAP LAMBERT Academic Publishing (December 12, 2017) ;
 11. **Durim Alija**, Eljesa Ziberi dhe Amir Alasani(2017). Sa njihen ushqimet e modifikuara gjenetike nga popullata e zonës së Pollogut. Konferenca e gjashtë studentore, Tiranë, 2017;
 12. Ismail Ferati ,Bizena Bijo, **Durim Alija** , Eljesa Ziberi (2017). The presence of aflatoxin M1 on processed milk in the Republic of Kosovo. UBT 6 th Annual International Conference;
 13. Xhezair idrizi, Eljesa Ziberi, **Durim Alija** (2017). The protein content in some beans populations in northwestern Macedonia. www.molbiotech.gen.tr
 14. **D Alija**, E Ziberi, G Xhabiri, X Idrizi, N Durmishii, I Ferati (2017)Control of Vitamin C (ascorbic acid) in non-alcoholic and fresh drinks , UBT 6th ANNUAL INTERNATIONAL CONFERENCE 2017;
 15. Xhezair Idrizi, Erhan Sulejmani, **Durim Alija** (2017):Study of bio-morphological parametrs of some aromatik-medical plants from Sharr mountain in Macedonia. (2017) Conference: International symposium on medicinal aromatic and dye plants, At: Malatija, Turkey;
 16. Xhezair Idrizi, Merita Saliu, **Durim Alija**, Namik Durmishi,Gafur Xhabiri (2017), Comparison of some quality and safety parameters in drinking water in Pollog region, UBT 6th ANNUAL INTERNATIONAL CONFERENCE 2017;
 17. Xhezair Idrizi, Xhabir Abdullahi, Namik Durmishi, Gafur Xhabiri, **Durim Alija**, Fejzullah Fejzullahi.(2017) The protein content in some beans populations in pollog region. International congress on plant science and technology;
 18. Gafur Xhabiri, Xhezair idrizi, Namik Durmishi, Ismail Ferati, , **Durim Alija**. (2016) Qualities of some barely varieties cultivated bin the region of pollog. www.molbiotech.gen.tr

Krahas moshës së re, Mr.Sc. Durim Alija do të vazhdojë me veprimatri shkencore-hulumtuese, ku do të thellohet edhe më tepër duke publikuar punime shkencore në zhurnale me impakt-faktorë.

PROPOZIM

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit - Mr. Sc. Durim Alija, mbështetur në kërkesën për angazhim/avancim të kuadrit mësimor-shkencor, gjykon se me punën e tij të dëshmuar profesionale, arsimore e shkencore, si dhe me nivelin e duhur të dijes, kontributin, zellin dhe përkushtimin në punë, interesimin dhe angazhimin për hulumtime shkencore, Mr.Sc. Durim Alija, i plotëson kushtet ligjore të zgjidhet në titullin për të cilin ka konkurruar.

Në fushën profesionale, ai posedon aftësi për realizim cilësor të punëve dhe ushtrimeve laboratorike. Nga ana tjetër, kryerja e studimeve deri-diplomike në kohën e duhur me mesatare 9,87 si dhe vazhdimi i studimeve post-diplomike me mesatare absolute 10,00, njohja e gjuhës angleze, pjesëmarrja në konferenca, botime nëpër revista ndërkombëtare e internacionale, krahas moshës së re, dëshmojnë për aftësinë dhe gatishmërinë e tij profesionale për tu përballur me sfidat hulumtuese-shkencore, në fushën e teknologjisë ushqimore. Në fushën e arsimit, ai posedon aftësi për mësimdhënie cilësore dhe inovative.

Bazuar në atë që u cek më lartë, kemi nderin dhe kënaqësinë që këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, t'i propozojmë që **Mr.Sc. Durim Alija**, të zgjedhet në titullin mësimor-shkencorë: **ASISTENT**, në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit në Universitetin e Tetovës **në lëndët në fushën e teknologjisë ushqimore.**

KOMISIONI RECENSUES:

Prof. Dr. Xhabin Abdullahu – Kryetar

Doc. Dr. Ismail Ferati – Anëtar

Doc. Dr. Gafur Xhabiri – Anëtar

S H T O J C Ë

PËR ZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSVE NË TË GJITHA THIRRRJET MËSIMORE-
SHKENCORE DHE PËR ZGJEDHJE NË THIRRRJE TË BASHKËPUNËTORËVE NË
UNIVERSITETIN E TETOVËS

Kandidati: Mr. Sc. Durim ALIJA

Institucioni: Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit

Lëndët: Lëndë në fushën e teknologjisë ushqimore

Titulli : Asistent

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rend	Emërtimi i aktivitetit		Pikët
1.	Mbajtja e Ushtrimeve		
1.1	Teknologjia e përpunimit të drithërave	3x15x0.03x3	4.05
1.2	Teknologjia e përpunimit të fruta-perimeve	3x15x0.03x3	4.05
1.3	Kontrolli i kualitetit të produkteve ushqimore	3x15x0.03x4	5.4
1.4	Kimia ushqimore	3x15x0.03x1	1.35
1.5	Kimia dhe biokimia ushqimore (Të ushqyerit)	3x15x0.03x1	1.35
1.6	Cilësia dhe siguria e ushqimit (Të ushqyerit)	2x15x0.03x4	3.6
1.7	Bioteknologji ushqimore	2x15x0.03x3	2.7
1.8	Bazat e toksikologjisë	2x15x0.03x1	0.9
1.9	Operacionet teknologjike 2	2x15x0.03x1	0.9
1.10	Operacionet teknologjike (MCSU)	2x15x0.03x1	0.9
2.	Përgatitja e lendeve te reja		
2.1	Ushtrime	10x1.5	15
3.	Konsultime me studentet		
3.1	40 student x 1 x 0.002	40x0.002	0.008
	Gjithësej		40.20

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. rend	Emërtimi i aktivitetit	Pikët
1.	Teza e magjistraturës ““Vlerësimi krahasues i përmirësuesëve (aditivëve) në cilësitë sensorike, reologjike dhe brumbërëse të miellit nga kultivarë të ndryshëm të grurit”	4
2.	Monografi e botuar në perendim	
2.1	Durim Alija , Eljesa Ziberi, Xhezair Idrizi. Control of Vitamin C (Ascorbic Acid) in Non-Alcoholic and Fresh Drinks Paperback – (2017). Paperback : 64 pages, ISBN-10 : 6202197560, ISBN-13 : 978-6202197564, Publisher :LAP LAMBERT Academic Publishing (December 12, 2017) ;	12
2.2	Xhezair Idrizi, Renata Kongoli, Durim Alija (2020): Study and Safety Parametrs in Raw Raspberries, LAP LAMBERT Academic Publishing, ISBN:978-620-2-81663-2;	12
2.3	Citime nga botimet shkencore (10x2.0)	20
3.	Punime me rezultatet shkencore origjinale, të publikuara në revista referente shkencore-profesionale, me këshill redaktues ndërkombëtar	
3.1	Xhezair Idrizi, Renata Kongoli, Durim Alija (2020): Study and Safety Parametrs in Raw Raspberries, LAP LAMBERT Academic Publishing, ISBN:978-620-2-81663-2;	4.8
3.2	Xhezair IDRIZI , Xhabir ABDULLAHI , Durim ALIJA , Gafur XHABIRI, Namik DURMISHI, Ismail FERATI.(2019) The protein content in some beans populations in Northwestern Macedonia. INTERNATIONAL CONGRESS ON NATURAL, HEALTH SCIENCES AND TECHNOLOGY;	3.6
3.3	Xhezair IDRIZI, Merije ELEZI, Hava MIFTARI, Erhan SULEJMANI, Fejzullah FEJZULLA, Durim ALIJA .(2019) Possible application of herbs as functional products in food industry. INTERNATIONAL CONGRESS ON NATURAL, HEALTH SCIENCES AND TECHNOLOGY;	3.6
3.4	Ismail Ferati, Namik Durmishi, Xhezair Idrizi, Gafur Xhabiri, Hava Miftari, Durim Alija (2019), Effect environmental factors on microbiological quality of flour, ISBN 978-9951-550-19-2, https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2019/events/432/	3.6
3.5	Besim Ismaili, Durim Alija , Xhezair Idrizi (2018) Nutritionism for Athlets. 5th International Balkan conference in Sport science;	4.8
3.6	Xhezair Idrizi, Xhabir Abdullahi, Gafur Xhabiri, Durim Alija (2018), The evulation of phenotypic varation of native populations of bean in Macedonia, International Journal of Food Technology and Nutrition, Volume1, Issue1-2, Pages19-23 Publisher.Faculty of Food Technology and Nutrition, Tetova, Republic of North Macedonia.	3.6


Nr. rend.	Emërtimi i aktivitetit		Pikët
1.	Pjesëmarrje në aktivitetet promovuese të fakultetit	10x1.0	10
2.	Anëtarë bordi editorial në revista shkencore nacionale dhe internacionale	2x1.0	2
3.	Pjesëmarrës në konferenca shkencore	10x1.0	10
Gjithësej			22

III. REFERENCAT PËR ZGJEDHJEN E KANDIDATIT

Nr. rend.	VEPRIMTARITË	Pikët
1.	MËSIMORE - ARSIMORE	40.20
2.	HULUMTUESE - SHKENCORE	123.4
3.	ME INTERES TË GJËRË	22
GJITHËSEJ		185.6

KOMISIONI RECENSUES:

Prof. Dr. Xhabir Abdullahu – Kryetar



Doc. Dr. Ismail Ferati – Anëtar



Doc. Dr. Gafur Xhabiri – Anëtar